

- truallin ku do të ndërtohet objekti i banimit me sipërfaqje 1700 m^2 , të ndodhur në Zonën kadastrale 8561, me nr.pasurie 1/860, Lagija nr.10, Rruga: "Theollor Kavalkjoti", të lirë fizikisht dhe juridikisht/ligjërisht, nëpërmjet kontratës së dhurimit për dhurimin e truallit në favor të EKB-së, pasi të jetë prishur objekti ekzistues, si dhe pajisja e Bashkisë Korçë me çertifikatën për vërtetim pronësie për këtë pasuri;
- dokumentacionin tekniko-ligjor (çertifikatën për vërtetim pronësie të lirë nga çdo kufizim, barrë hipotekore, etj..) që disponohet për truallin ku do të ndërtohet;
- c) të vëré në dispozicion të EKB-së lejen përkatëse të zhvillimit dhe ndërtimit për objektin e banimit, brenda afatit ligjor nga momenti i aplikimit online nga EKB për këtë objekt, të pajisur me studim;
- d) të eleminojë pagesën e taksës mbi infrastrukturën me Vendim nga Këshilli Bashkiak;
- e) të investojë për sistemimin dhe infrastrukturën e zonës, duke përfshirë edhe rrjetin inxhinierik;
- f) të sigurojë brenda një afati 2 (dy) mujor nga data e njoftimit/kërkesës nga Enti Kombëtar i Banesave (*referuar nenit 73, pika 2/a të Ligjit Nr.22/2018 i ndryshuar*), sipas kritereve të negociuara mes palëve, listën e familjeve përfituese të këtij programi, të miratuar nga Këshilli Bashkiak Korçë ku të jenë specifikuar për çdo familje: pallati, kati, numri i apartamentit, struktura, sipërfaqja respektive dhe statusi i familjes nëse ka në përbërje persona PAK.
- g) të garantojë EKB-në se do të përgjigjet për çdo detyrim ndaj palëve të treta të cilat kanë dhe/ose mund të ngrenë pretendime për truallin që vendoset në dispozicion për realizimin e këtij investimi.

4. Palët bien dakord që:

- a) Ndarja e apartamenteve të banimit, për familjet që do të përfitojnë strehim nga ky investim, do të bëhet me vendim të Këshillit Bashkiak Korçë, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave, konform legjislacionit në fuqi.
- b) Mënyra e shitjes së apartamenteve do të realizohet duke zbatuar një nga mënyrat e miratuara me Vendimin e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Neni 4 Vlefshmëria dhe zbatimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët. Vlefshmëria e marrëveshjes mund të zgjatet me mirëkuptimin dhe vullnetin e palëve, kur këta të fundit nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre në kohë. Marrëveshja mund të rishikohet dhe të ndryshojë vetëm me shkrim dhe me nënshkrimin e të dy palëve.

Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre me negociata direkte dhe me mirëkuptim. Në rast të kundërt, mosmarrëveshjet do të zgjidhen sipas procedurave juridike ligjore në fuqi, bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë.